

# Raport - Progresi i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit

(Dhjetor - Janar 2013)

## Në fushën e standardizimit

Implementimi i Planit Kombëtare për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), i cili reflekton detyrimet e DPS ndaj nenit 75 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe rekomandimet e raportit analitik të Komisionit Evropian (KE) të vitit të kaluar, ka qenë objektiv kryesor në punën e tonë.

Gjithashtu është punuar për përgatitjen e Draft Strategjisë Kombëtare të Standardizimit – pjesë e Strategjisë për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut, 2013-2020.

Për sa i përket anëtarësimit me të drejta të plota në *CEN dhe CENELEC*, gjatë viti 2013, DPS-ja ka vijuar punën për plotësimin e kriterëve siç kërkohen në Guidën 20 “Udhëzues mbi kriteret e anëtarësimit” të CEN dhe CENELEC. Paketa ligjore e DPS-së dhe të gjitha rregullat dhe procedurat për aktivitetet në fushën e standardizimit janë në përputhje me parimet e standardizimit Evropian, si standardizimi vullnetar, transparenca, konsensusi, paanshmëri në proces dhe koherencë.

Bordi Drejtues i DPS është mbledhur në muajin Korrik, ku u zgjodh Kryetari i Bordit, përfaqësues nga ARZH (Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Tiranë).

Bordi Teknik ka zhvilluar dy mbledhje gjatë 2013 dhe ka miratuar programin e punës së standardeve.

Lidhur me *riorganizimin administrativ*, DPS nuk ka pasur ndryshime për sa i përket strukturës apo punonjësve përveç dorëheqjes së drejtorit të përgjithshëm, në Dhjetor të këtij viti.

Në Mars 2013, DPS-ja është pranuar anëtare me të drejta të plota në Institutin Evropian të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI). Për adoptimin e standardeve ETSI, janë ngritur nga DPS dy (2) Komitete Teknike.

*Adoptimi i Standardeve Evropiane*, gjatë vitit 2013 janë adoptuar në total **2269** standarde, **272** amendamente dhe **380** dokumente standardizimi, nga të cilat:

**1902** janë Standarde Evropiane EN;

- **954** standarde të publikuar nga CEN;
- **484** janë standarde të publikuara nga CENELEC dhe
- **464** janë standarde të publikuara nga ETSI.

Për më tepër, janë adoptuar si standarde shqiptare:

**367** Standarde ndërkombëtare, nga të cilat

- **268** standarde publikuar nga ISO dhe
- **99** publikuar nga IEC.

Janë adoptuar në total si Standarde Shqiptare (SSH) **18.093** EN dhe HD përfshirë amendamentet nga të cilat:

**12.577** janë standarde të publikuara nga CEN;

**5.052** publikuar nga CENELEC dhe

**464** publikuar nga ETSI.

Numri i standardeve ndërkombëtare (ISO dhe IEC) adoptuar si standarde shqiptare është **2.755**.

Janë adoptuar **100%** e Standardeve Evropiane të Harmonizuara si Standarde Shqiptare të Harmonizuara.


Adoptimi i standardeve është realizuar vetëm me metodën me faqe të parë.

Gjatë vitit 2013 totali i standardeve Evropiane dhe Ndërkombëtare të shfuqizuara është si më poshtë:

- **162** (SSH EN) Standarde Evropiane;
- **6** (SSH ISO) Standarde Ndërkombëtare;
- **8** amendamente dhe
- **21** dokumente standardizimi.

Grafiku më poshtë tregon gjendjen aktuale të Standardeve Shqiptare dhe strukturën e tyre sipas origjinës:

Gjendja aktuale e S SH-ve dhe struktura e tyre sipas origjinës




Origjina	S SH	S SH EN	S SH ISO+IEC	Të tjera	Totali
Standardet	3055	18093	2755	744	24647

Me qëllim rritjen e *ndërgjegjësimit*, gjatë vitit 2013, DPS-ja ka përdorur faqen zyrtare të internetit, si një mjet për dhënie të informacionit rreth saj, aktiviteteve dhe arritjeve në fushën e standardizimit. Ajo përmban procedurat për kërkimin dhe gjetjen e standardeve shqiptare, informacion për mbledhjet e Bordit Drejtues dhe Bordit Teknik, mbledhje dhe ngjarje ndërkombëtare, paketa me standarde të reja, buletinet informative, Katalogun e Standardeve Shqiptare 2013 si dhe artikuj të ndryshëm. Janë përgatitur në këtë periudhë, 3 buletine informative në format letre dhe elektronikisht në CD, të cilat janë në dispozicion edhe në faqen tonë të internetit [www.dps.gov.al](http://www.dps.gov.al).

*Shitja e standardeve* është bërë me përputhje të plote me legjislacionin shqiptar dhe Guidat 10 dhe 12 të CEN dhe CENELEC.

Gjatë kësaj periudhe janë shitur në total **1654** Standarde Shqiptare (SSH), nga të cilat **1519** janë standarde Evropiane (SSH EN). Nëse hedhim një vështrim rreth origjinës së standardeve të shitura gjatë 2013, vihet re një rritje e dukshme e standardeve EN krahasuar me të njëjtën periudhë të viti 2012, siç edhe jepet në grafikun më poshtë:



*Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pikë Referimi në OBT dhe CEFTA.* Edhe gjatë këtij viti DPS ka notifikuar në Qendrën e Përbashkët të Informacionit të ISO/IEC, programet 6-mujore të punës së standardeve dhe ka notifikuar në CEN dhe CENELEC, të gjitha standardet e adoptuara si Standarde Shqiptare dhe gjithashtu mënyrën e adoptimit.

Lidhur me detyrimet e DPS-së si Pikë Referimi në OBT dhe CEFTA, janë qarkulluar rregullisht të gjitha notifikimet e marra nga vendet anëtare të OBT, në të gjitha ministritë dhe institucionet shtetërore, sipas përkatësisë. Gjatë këtij viti kanë janë realizuar **3** notifikime sipas marrëveshje së CEFTA dhe OBT/TBT i draft ligjeve të ardhura nga ministria e Bujqësisë. Përmbajtjet ligjore janë dërguar me kërkesë të vendeve anëtare. Në një vështrim të përgjithshëm janë kryer **67** notifikime të draft akteve ligjore dhe ligje të cilat kanë një impakt në tregtinë ndërkombëtare dhe **20** në CEFTA.

#### **Objektivat për 2014:**

- Progres në plotësimin e kriterëve për anëtarësimin me të drejta të plota në CEN dhe CENELEC;
- Implementimin korrekt të kuadrit ligjor të DPS-së;
- Azhurnimi i rregullave dhe procedurave të punës në përputhje me rregullat e CEN/CENELEC dhe ETSI;
- Progres në realizimin e planit për adoptimin e standardeve Evropiane dhe Ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH);
- Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomike vendas mbi rolin e DPS-së në tregun e lirë dhe mbi rëndësinë e përdorimit të standardeve Evropiane në produktet dhe shërbimet
- Rritje në numrin e shitjes së standardeve;
- Pagesa në koha e tarifave të anëtarësimit në organizmat Evropiane dhe Ndërkombëtare për Standardizim (CEN/CENELEC, ETSI, ISO dhe IEC);
- Rritja e ndërgjegjësimit në drejtim të pjesëmarrjes së palëve të interesuar në procesin e standardizimit.
- Sigurimi në vijim i transparencës dhe informimit të publikut të gjerë nëpërmjet publikimeve të DPS-së (Buletinet Informativë, Katalogu i Standardeve Shqiptare dhe publikimeve të tjera).

Janar 2014.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)